

KUD 338

PERCAKTUESIT E RITJES EKONOMIKE

Leonita Mazrekaj
leonita.m@gmail.com

Abstrakt

Ky punim ekzaminon percaktuesit e norms se kursimeve si mjet kyq ne rritjen ekonomike, duke prezantuar te gjeturat dhe analiza tjera te perpunuara nga te dhenat e autorit Weil (2004). Punimi tutje diskuton supozimet baze te modelit Solow dhe rolin e kursimeve ne mireqenien ekonomike. Poashtu do te behet permbledhje e rezultateve te analizuara duke I vendosur ato ne kontekstin e politikave rekomanduese. Vemendje e veqant do ti kushtohet marrdhenies ne mes rritjes ekonomike dhe kursimeve, dhe ndikimit te politikave specifike ne normat e kursimeve. Punimi do te konkludoj me paraqitjen e politikave rekomanduese ne terheqjen e normave me te larta te kursimeve.

Fjalet kyqe: Norma e kursimeve, Norma e rritjes ekonomike GDP/ koke banori, Norma e zenies ne edukim, Norma e natalitetit, Norma e moshes se varur

Jel: E20, E21, E22

I. Hyrje

Duke qene deshmitar ne gjysmen e shekullit te fundit, kemi verejte se bota ka kaluar ne sfera te ndryshme te rritjes ekonomike. Bazuar ne te dhenat e Bankes Boterore¹⁰⁷, vendet ne zhvillim jane rritur me norm mesatare prej 2-3%, te percjellur me kryesuesit e disa vende aziatike qe kane pas nje rritje me te lart prej 6-9%, derisa vendet e Afrikes treguan ulje ne normen e rritjes, dhe ate me koeficient negative. Kjo divergjence e norms se rritjes eshte reflektuar ne boshllekun e te hyrave ne mes shteteve te pasura dhe te varfera. Ky boshllek eshte rritur rreth 25 here qe nga viti 1950¹⁰⁸, matur nga GDP per person, I cili eshte vazhdimisht ne rritje. Keshtu qe, eshte e natyrshme te pyesesh se si kja pabarazi e te hyrave dhe pasurise, shkaktuar nga faktor te ndryshem te rritjes ekonomike mund te sqarohen. Ne fakt, Kosova, eshte nje shtet I ri I cili I takon kategorise se nje shteti ne zhvillim, kjo do te mund te sqarohej se si trendi I zhvillimit ekonomik eshte kufizuar, duke pas parasysht

¹⁰⁷ www.worldbank.org

¹⁰⁸ B.Milanovic, Matja e (2005)

=====

veshtiresit ne te cilat ka kaluar per vite me radhe. Mirepo, ne mungese te dhenave statistikore eshte e pamundur te paraqitet nje analize e mirefillte, dhe si pasojë do te konsiderojme shtetet tjera te cilat permbajne situatë te njejte te zhvillimit ekonomik, si model per te reflektuar trendin e ndikimit te norms se kursimeve ne rritjen ekonomike. Pra, cilet jane percaktuesit kryesor te rritjes ekonomike? Ky eshte subjekti kryesor I cili adresohet ne kete punim, duke u bazuar ne te dhena analitike, ne shqyrtimin teorik dhe evidenca empirike te vendeve ne zhvillim. Qe nga paraqitja e modelit te rritjes ekonomike, nga Solow (1956), vemendje e lart I eshte kushtuar shqyrtimit te rolit te norms se kursimeve ne normen e pergjithshme te investimeve. Modeli Solow ka vene theks te veqant ne nivelin e kapitalit per koke banori ne rritjen ekonomike. Prandaj, ne kete punim do te investgohet nderlidhja ne mes norms se kursimeve dhe rritjes ekonomike, si dhe korelacioni i normes se kursimeve dhe karakteristikave tjera te zhvillimit ekonomik. Per me teper, do te dikutohen edhe politikat rekomanduese te cilat hapin rrugen drejt mireqenies ekonomike ne shtetet e varfera.

Struktura e punimit eshte si vijon. Separi, punimi pasqyron te dhena lidhur me normat e kursimeve ne mes shteteve, duke vazhduar me nderlidhjen ne mes te hyrave nacionale per koke banori dhe norms se kursimeve. Efektet fundamentale te normave te ndryshme te kursimeve ne mes shteteve shqyrtohen dhe sqarohen tutje bazuar ne variable e shume shteteve. Si variabla te pavarura jane definuar, norma e zenies ne edukim, norma e natalitetit dhe norma e moshes se varur¹⁰⁹, variabla te cilat jane kyqe ne shtete ne zhvillim dhe ne menyre te qart sqarojne diferencat ne normen e kursimeve. Ne fund, punimi konkludon me politika rekomanduese te cilat kane efekt ne normat e kursimeve bazuar ne te gjeturat e hulumtimit.

Te dhenat empirike

Baza e te dhenave empirike te perdorura per analiza jane marr nga Weil (2004). Te dhenat permbajne informata nga 176 shtete nga 1960-2000. Ketu do te shqyrtojme percaktuesit e kursimeve te familjeve, duke perdor seri periodike te te dhenave te shume shteteve.

II. Niveli mesatar I Norms se Kursimeve

Me perdorimin e te dhenave empirike, eshte gjetur se norma e kursimeve ndryshon nga shteti ne shtet. Mesatarja e kursimeve ne keto vende sillet rreth 16.6%, e cila dukshem eshte e ulet, krahasuar me nevojen qe

¹⁰⁹ Moshë e varur konsiderohet nga 0-16 dhe 65 e me shume, te cilet mbahen nga fuqia e zene me pune te cilet paguajne nje pjese e te hyrave te tyre, per mireqenien dhe shpenzime tjera ne nevoje.

parasheh nje vend ne rritje. Duke krahasuar ne nivel me te lart, ne tabelen e renditjes se shteteve ,shohim qe, Eriteria ka normen me te ulet te kursimeve me -32% dhe Equatorial Guinea¹¹⁰ ka norme te kursimeve me te lart me rreth 74% .Si rrjedhoje do te eksplorojme dhe definojme, pse disa shtete perjetojen norma te ndryshme te rritjes se kursimeve, duke perdorur supozime te ndryshme ekonomike. Ne vijim, do te paraqesim tabelen dhe grafikun me permbatje te shperndarjes se kursimeve ne mes shteteve.


Figura 1

Shperndarja e Normes se Kursimeve 2000

Tabela 1

Norma e Kursimeve 2000

Norma mesatare e kursimeve	16.6%
Varianca	2.4%
Minimumi I Normes se Kursimeve	32.0%
Maximumi I Normes se Kursimeve	74.0%



Ndryshimi I norms se kursimeve eshte pershkruar nga lartesia e bareve ne grafik duke pasqyruar keshtu diferencen ne mes shtetev ete pasura dhe te varfera. Siq edhe verehet ka nje numer shume te vogel te shteteve te cilat zoterojne perqindjen me te madhe te pasurise krahasuar me numrin e shteteve te cilat zoterojne nje numer te vogel te pjesemarrjes ne pausri. Niveli I Normes se Krsimeve te Shteteve te Ndryshme per 2000

	Saving Rate(mean)	Top 10 Shtetet e pasura	GDP/2000	Saving Rate	Top 10 Shtetet e varfera	GDP/2000	Norma kursimeve e
OECD countries (29countris by 2000)		Luxembourg	47020.31	42.00	Congo, DemRep	245.821	-
Regions		USA	35586.88		Tanzania	515.074	9,21
Africa	11.20	Singapore	31130.2	49.76	Burundi	559.257	-5,57
Asia	24.64	Norway	28924.91	38.26	Ethiopia	678.313	-1,13
Western Europe	25.91	Canada	28758.22		Sierra Leone	704.547	-8,08
North America		Hong Kong	28538.04	32.29	Eriteria	730.878	-32,41
South America		Denmark	28441.59	27.48	Guinea-Bissau	735.219	-8,77
		Switzerland	28233.58		Nigeria	755.544	34,03
		Ireland	28198.26		Malawi	837.789	1,12
		Australia	27320.03		Yemen	873.436	28,15

¹¹⁰ Equatorial Guinea perjetoj nje rritje te lart te GDP pas zbulimit te rezervave te petrolit ne vend, ne vitin 1996.

III. Nderlidhja ne mes Normes se Kursimeve dhe te Hyrave per koke banori

Tabela 2
Tabela e Korrelacionit

. corr savings00 gdpcc00
(obs=144)

	savin=00	gdpcc00
savings00	1.0000	
gdpcc00	0.4518	1.0000

Figura 2
Norma e kursimeve dhe norma e GDP/capita (per koke banori) 2000




Figura e dyte, prezanton nderlidhjen ne mes GDP/per koke banori dhe te norms se kursimeve. Ne vijen horizontale paraqitet GDP/per koke banori ndersa ne ate vertikale norma e kursimeve, te dyja keto per vitin 2000. Kjo tregon, se ka nje korrelacion positive ne mes te GDP/per koke banori dhe te norms se kursimeve. Pra, me rritjen e norms se kursimeve rritet GDP per koke banori. Ne menyre intuitive verehet qe ne shtetet e varfera, ku familjaret jetojne nen nivelin e mbijeteses, me te hyrat qe disponojne, nuk mund te perballojne te kursejn aq sa mund te kursejn shtetet e pasura. Ky fakt eshte mire I dokumentuar perms hulumtimeve te shumta empirike. Nje nga keta hulumtues ishte edhe Saltz(1999). Ne studimin e tij, shteti me te hyra te larta per koke banori tregon norme me te lart te konsumit dhe kursimit. Ne anen tjeter,po ashtu verejme, qe ne mase te madhe shprehet varianca e norms se kursimeve, edhe ne mes shteteve te varfera. Nese norma e kursimeve percaktohet nga te hyrat e uleta, si mund te sqarojme normen relativisht te lart te kursimeve te disa shteteve te varfera dhe anasjelltas.Kjo me se miri theksohet me ate qe, norma e kursimeve nuk percaktohet vetem nga kufizimet e shteteve te varfera me te cilat ato ballafaqohen, por ne fakt varen nga zgjidhjet qe disa shete bejne. Kjo ide eshte diskutuar nga Weil (2008), I cili thekson qe, njerzit e varfer nuk pasqyrojne vetem mungesen e te mirave material por edhe asgjesimin e te ardhmes, nga e cila ata heqin dore. Ne tabelen e korrelacionit tregohet qe 1% rritje/ulje e norms se kursimeve do te rrit/ule GDP/per koke banori per 0.45%.


IV. Nderlidhja ne mes Normes se Kursimeve dhe Normes se Rritjes Ekonomikee

Tabela 3
Tabela e korrelacionit

```
. corr avgsave growth60_00
(obs=61)
```

	avgsave	growth-00
avgsave	1.0000	
growth60_00	0.3381	1.0000

Figura 3
Norma e kursimeve dhe norma e rritjes se GDP/per koke banoricapita 1960-2000



Tutje, ne punim ekzaminohet nderlidhja ne mes norms mesatare te kursimeve dhe norms se rritjes te GDP/ per koke banori, nga 1960-2000. Sipas figures se trete, norma e larte e kursimeve, eshte fuqishem e nderlidhur me normen e larte te rritjes ekonomike. Bazuar ne modelin Solow (1956), ekzisotn nje pikenisje ne nivelin e kapitalit dhe te hyrave ekzistuese, te cilat percaktojne se a ka shteti norme te ulet apo te lart te kursimeve, ku si pasoje, percaktohet norma e rritjes se te hyrave permes rruges kaluese ne piken e qendrueshme te nivelit te te hyrave. Per shembull, kemi verejte ne tabelen e nivelit te kursimeve ne mes shteteve te ndryshme , qe Singapor me norme mesatare te kursimeve prej 29.2%, ka pas rritje te GDP/per koke banori te dhjetefishuar nga 1960-2000. Ky eshte nje imlipkacion I mjaftueshem per te sqaruar nivelin e ulet te norms se rritjes ne vende te varfera. Ngase dikur, Singapor, ishte nder shtetet me te varfera krahasuar me disa shetet qe edhe tani kan ngec te varfera. Pra, nga kjo mesojme qe jo vetem kapitali ekzistues, por edhe vet menyra e menaxhimit me eficence te burimeve, kontrolli I korrupcionit si dhe qeverisja, poashtu ne anen tjeter, zgjidhja e vet populates ndikojne ne normen e kursimeve, e cila eshte percakutese ne normen e rritjes ekonomike. Me lart tabela e trete tregon koeficientit te korrelacionit, I cili eshte, 1% rritje/ulje ne normen e kursimeve GDP rritet/ulet per 0.33%. Nese supozojme qe kursimet varen nga indikatorët e brendshem, shtetet e varfera marrin me shume kohe ne arritjen e nje niveli te qendrueshem te te hyrave.


V. Nderlidhja ne mes Normes se Kursimeve dhe Zenia e Popullates ne Edukim

Tabela 4
Tabela e Korrelacionit

. corr savings00 secenro1100
(obs=112)

	savin-00	secen-00
savings00	1.0000	
secenro1100	0.2724	1.0000

Figura 4
Norma e Kursimeve dhe Zenia ne Edukim 2000



Nga figura e katert, verejme qe ekziston nje norme positive e moderuar e korrelacionit, qe shtetet me norme me te larte te zenies ne edukim, kane norme me te larte te kursimeve. Perderisa edukimi paraqet nje person i cili ka perspective te gjat kohore ne planin jetesor, zgjedhja per te investuar, si kthim ne Kapitalin njerzor ne te ardhmen, mund te interpretohet qe , familjet kane tendence te ndryshojne satisfacionin e konsumit te tanishem per te realizuar paga me te larta ne te ardhmen. Si rrjedhoje, kjo reflekton norme me te lart te kursimeve. Ne anen tjeter, kur shteti arrin norme mesatare te zenies ne edukim, sjellja e familjareve ne kursime eshte edhe me ambicioze. Keshtu qe, kerkohet hulumtim i metutjeshem per te sqaruar :1)nese te priturat per paga me te larta ne te ardhmen tereqin prirjen per konsum apo kursim, dhe 2) nese ndjekja e edukimit me te larte garanton te priturat ne paga me te larta. Tabela e katert tregon koeficientin e korrelacionit, i cili eshte, 1% rritje/ulje ne zenie me edukim do te shkaktojte 0.272% rritje/ulje ne normen e kursimeve.


VI. Nderlidhja ne mes Normes se Kursimeve dhe Normes se Natalitetit

Tabela 5
Figura e korrelacionit

. corr savings00 fertility00
(obs=145)

	savin-00	ferti-00
savings00	1.0000	
fertility00	-0.2779	1.0000

Figura 5
Norma e Kursimeve dhe Norma e Natalitetit



Krahasuar me variablet e matura me lart, regresioni ne sqarimit e ndikimit te natalitetit ne normen e kursimeve, siq verehet nga figura e peste, tregon nje korrelacion negativ. Shansi I femijeve per te mbijetuar ne shtete e varfera eshte relativisht I ulet, per arsye te ndryshme, Si rrjedhim, shtetet e varfera e shohin normen e larte te natalitetit si nje investim strategjik, por ne anen tjeter, normat e larta te natalitetit ndikojne ne limitimin e burimeve ne nivel te pergjithshem. Per me teper, shume autor kane eksploruar strukturen demografike dhe kane treguar nderlidhje te fuqishme ne varesine e prinderve per mbeshtetjen e femijeve, gjate pensionimit te tyre, me normen e natalitetit. Siq ka treguar edhe studimi I Romeo (2003) dhe Bahchieva (1998) ndikimin e ketyre variablave. Konkludimi kryesor I tyre ishte qe, femijet jane nje investim ekonomik per popullatat e varfera, sidomos ne prezencen e moshave te vjetra qe gjinden ne pension, te cilat vazhdimisht percillen me projekte ne mbeshtetje per mbijetese, nga bota nderkombetare. Kjo nenkupton, qe norma e natalitetit, eshte me e larte ne pjeset me te varfera te populates, per shkak se fenomeni bazuar ne pensionimin e prinderve, eshte me I perhapur. brenda popullates me te hyra te uleta. Nga kjo mund te shohim qe, te pasurit ndikim te brendshem ne natalitet dhe ndikimi ne politikat e femijeve, percakton te dyja, dinamiken tranzacionale dhe piken e qendrueshme ne ekonomi. Regjimet e uleta dhe te larta te zhvillimit ekzistojne, sido qe te jete, ato mund te percaktohen edhe nga politikat qeveritare. Ne veqanti, pavaresisht se a starton ekonomia me rezerva te larta apo te uleta te kapitalit, nje rritje ne shumen e shpenzimeve publike ne shendetesi, perfaqeson stimulim ne akumulimin e kapitalit, rritje te hyrave per koke banori, dhe rritje te jetegjatesise si dhe reduktim te natalitetit, e cila ndikon ne largimin e varferise se perhershme. Siq tregon tabela e peste, 1% rritje/ulje e norms se natalitetit do te shkaktoj rritje/ulje negative prej 0.277%.


VII. Nderlidhja ne mes Normes se Kursimeve dhe Norms se Moshes se Varur

Tabela 6
Figura e korrelacionit

. corr agedepend00 savings00
(obs=145)

	agede-00	savin-00
agedepend00	1.0000	
savings00	-0.3241	1.0000

Figura 6
Norma e Kursimeve Norma e Moshes se Varur



=====

Ne vazhdim, ne figuren e gjashte, do te japim nje reflektim te nderlidhjes ne mes norms se kursimeve dhe norms se moshes se varur (kjo norme paraqet pjesen e popullsisë e cila nuk I takone moshes se fuqise punetore ne raport me popullaten e cila I takon fuqise punetore). Kjo nderlidhje eshte paraqitur edhe grafikisht, e cili jep detaje lidhur me pritjet e sjelljeve mbi normat e kursimeve dhe norms se moshes se varur. Struktura demografike percakton transferimin ne kohe te kursimeve. Njerezit tentojne te kursejne apo mos kursejn ne mosha te ndryshme, per te zbutur konsumin gjate intervalit jetesor. Si rrjedhoje, struktura demografike duhet te shiqohet si variable e rendesishme ne percaktimin e norms se kursimeve. Matthew Higgins, ne hulumtimin e tij deklaroi qe , norma e varesise eshte nje indikator I moshes ne strukturen e popullsisë, I cili bene perkufizimin e structures sociale ne nje shtet. Norma totale e varesise eshte numri I personave nder 14 vjeqar plus personat mbi 65 vjeqar. Eshte shuma e norms se te varurve te rinj dhe norms se te moshuarve. Efekti demografik nenkupton, qe rritja ne normen e varesise se te rinjeve dhe te moshuarve eshte e nderlidhur me norme me te ulet te kursimeve. Disa burime, si ato te studimeve empirike bere ne Kine nga Zheng (2007), tregojne qe norma e kursimeve eshte e nderlidhur negativisht me normen e varesise te te rinjeve dhe pozitivisht me normen e varesise se te moshuarve. Qfare nenkupton qe, te rinjte mund te konsiderohen si pjese e popullates ne nevojë per me shume konsum dhe investim te tanishem, perderisa te moshuarit paguhën si te pensionuar, e cila I bene ata me pak te varur. Kjo e fundit mund te sqarohet nga menyra e pageses se taksave qe ata I kane paguar gjate periudhes se zenies ne peridha me te hershme te jetes. ne te kauaren. Pohtu hulumtuesit, Mason dhe Fry (1982) zhvilluan nje model te quajtur ‘’, efekti I ndryshoreve te norms se rritjes’’ I cili, bene nderlidhjen ne mes te varesise se te rinjeve dhe kursimeve nacionale. Ky model mbeshetet ne njohurite te cilat motivojne teorine e ciklit jetesor te kursimeve, ku duke konsideruar rritjen positive te produktivitetit te punes, te rinjte gezojne te hyra dhe kosnum me te larte se sa te moshuarit e tyre. Kjo ve ne pah qe rritja e norms se te rinjeve, si nje fuqi punetore e ardhshme produktive, ne rrugen e balancuar te rritjes ekonomike, gjeneron te hyra me te larta, dhe keshtu edhe kursime me te larta. Ne fakt nje ekonomi e qendrueshme, mund te fitohet, nese struktura demografike varet nga faktor te brendshem, me qrast qeveria mund te praktikoj politika te planifikimit familjar. Intuita pas kesaj qendron ne ate qe, nese konsiderojme qe me shume njerez tentojne te jene te varur nga fuqia punetore, te cilet marrin page ne te tashmen, atehere nje pjese e ketyra pagave ndahet per ata te cilet nuk realizojne page, dhe ne fund kjo bene qe edhe te hyrat per koke te banorit te ulen, me qka edhe paraja e disponueshme eshte me e vogel per te kursyer.

=====

Nga kjo pritjet qe ulja ne normen totale te varesise te sqaroje rritjen e norms se kursimeve, Bazuar ne te dhenat emiprike, gjejmë qe prap korrelacioni ne mes ketyre variablave eshte ende I dobet, per shkak te lenies jashte te variablave te rinjeve dhe te moshuarve ne veqñati per te thelluar analizen e norms se kursimeve. Sido qe te jete, ne kete punim, jane marr stimulus tjere te variablave konstante te cilat tregojne variacionin e kursimeve e cila varet nga variacioni I rritjes se norms se moshes se varur. Tabela e gjashte, pasqyron qe, me 1% rritje/ulje ne normen e moshes se varur, norma e kursimit rritet/ulet per 0.32%.

VIII. Politikat dhe Norma e Kursimeve

Te gjeturat

Norma e kursimeve ne tere boten ndryshon ne mase te madhe: mesatarisht Asia kursen me shume se 24% te GDP-se ndersa Afrika kursen me pak se 15%. Diferencat regjionale jane rritur: ne tri dekadat e fundit norma e kursimeve eshte dyfishuar ne Azi ndersa ka stagnuar ne pjesen e Afrikes dhe Amerikes Latine dhe Caribbean. Ne shumicene shteteve, norma e larte e kursimeve percillet me norme te larte te hyrave, e deshmuar edhe nga modeli Solow (1956), sipas te cilit ekziston nje cikel I vete permbushjes se prirjes per kursim, mireqenies dhe varferise se pa shmangshme nga mungesa e kursimeve dhe stagnimi. Rezultat te njejt verejme tek norma e kursimeve dhe rritjes ekonomike qe paraqesin korrelacion pozitiv.

Gjithashtu faktoret kyq te cilet ndikojne ne shprehine e familjareve per kurseme kane dhene rezultate vijuese. Familjaret qe kane edukim me te larte kane gjasa te kursejne me shume, por perderisa ne familje ka me shume femije te cilet duhet te vazhdojne shkollimin, shoqeria ne kete rast nuk mund te perballoje te kurseje per te ardhmen. Keshtu qe, renia e norms se natalitetit I atribuohet norms me te larte te kursimeve. Poashtu shoqeria me strukture demografike me te re mund te kete norme me te larte te kursimeve.

Rekomandime

Para se gjithash, qeverite duhet te promovojne masa stimuluese ne manxhimin e te hyrave dhe shpenzimeve te pergjithshme, ashtu qe familjaret te kene te ardhura te disponuehsme per kursim. Duhet te evitohet korrupcioni, te rritet transparenca ne lidhje me investimet dhe grantet e jashtme, qe te rritet vetedijesimi, per alokimin me besueshmeri te mjeteve, ne ekonomi.

Poashtu duhet te rritet promovimi ne edukim universal per shoqerine per te arritur ne sepaku, nivelin e dyte te edukimit, ne menyre qe

=====

te rritet norma e kursimeve tek familjaret. Sido qe te jete, kur ne konsiderojme koston e edukimit I cili vjen nga familjaret, aty ekziston shpenzim I fshehur, I njohur si kosto oportune dhe plus kosto nominale. Nga kjo rrjedh qe qeverite duhet te ofrojne programe per edukim qe fakusohet ne aktivitete te gjenerimit te te hyrave per te varferit, siq jane shkolla profesionale, qe jane me pak te kushtueshme. Gjithashtu shkollat me programe mesimore lidhur me edukimin financiar mund te rrisin vetedijesimin mbi rendesine e planeve te kursimit per te ardhmen qe nga fazat e para te jetes

Se dyti, rritja e larte e popullesise ka efekt negative ne rritjen ekonomike ne periudha me te gjata. Per shembull, ‘politika nje femije per nje familje’, ne Kine ka qene e sukseseshme ne uljen e norms se natalitetit ne menyre qe te mbahet niveli I investimeve per koke banori. Ne te njejten kohe, kjo politik, poashtu, ka pasur konsekuenca te pa qellimshme. Renia e shpejt e numrit te femijeve per familje, ka qene kufizim ne normen e moshes se varesise, e cila tutje ka shteruar kursimet nacionale dhe planet e pensioneve. Keshtu qe, politikat e planifikimit familjar duhet te keshillohen me kujdes qe te promovojne norme te deshiruar te kursimeve. Qeverite mund te rrisin taksat e pensioneve ne menyra te ndryshme, te cilat lejojne financimin ne moshe te shtyer, ne njeran ane, poashtu te mbetet nje pjese e cila mund te kontribojne ne stimulimin e zenies ne edukim. Kjo prap varet nga struklurat dhe faktore tjer ekonomik dhe social, prandaj nuk mund te ipet nje model I cili do te vlente per te gjitha shtete njejt. Ngase, siq u pa edhe me lart, jo te gjitha kane prirje te njejta, dhe tentojne e investojne apo kursejne ne menyre te njejt. Bazuar ne supozimin se, te hyrat me te larta, terheqin prirje me te larte per konsum dhe kursim, prape, nga te dhenat e shteteve te OECD, verejme qe te hyrat me te larta jo gjithsesi qojne drejt normave me te larta te kursimeve. Ekzistojne arsye te ndryshme te cilat tregojne trendet intuitive te shteteve , siq jane, zhvillimi I sektorit financiar, norme te uleta te interest, norme te lart te konsumit, gjitha keto te shkaktuara nga efekti I pasurise se perceptuar, qe done te thote qe varesisht nga perceptimi I tyre per trendet e zhvillimit dhe pasurise qe nje shtet ka, ashtu edhe luhaten sjlljet e individualve, familjareve, bizneseve si dhe sektorit public, ne lidhje me normen e kursimeve.

Referenca:

- 1) Weil , D. (2008), Economic Growth, Addison Wesley.
- 2) Klaus Shmidt- Hebel and Luis Serven ,Savings Across the World, Puzzles and Policies, the World Bank Discussion Paper No.354

- 3) Mohan Ramesh (2006), Causal Relationship between Savings and Economic Growth in Countries with different Income levels, *Economic Bulletin* vol. 5 No.3 pp1-12
- 4) Zhou, Wei Bing,(2004) The Forecast and Reasearch on The Dependent Ratio For The Next Five Decades, *Statistical Research*, 21(11):35-38 (in Chinese).
- 5) Matthew Higgins. Demography, National Savings and International Capital Flow, December 1997,No 34 JEL classification: F21,J1
- 6) Andrew Mason (1998), Saving, Economic Growth, and Demographic Change, Vol. 14, No. 1, pp. 113-14
- 7) Gerard Jackson (2008) Article, Without Savings There Can Be No Economic Growth.
- 8) Websites:
<http://www.pensiondevelopment.org/394/the-impact-pension-systems-fertility.htm>
<http://finance.mapsofworld.com/savings/account/economic-growth.html>

=====